



Republika e Shqipërisë  
Universiteti i Sporteve të Tiranës  
Senati

Nr. 83, Prot.  
1/1

Tiranë, më 19.01 2017

VENDIM SENATI  
Nr. 6 datë 19.01 2017

Mbi

**miratimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit me karakter profesional, si dhe programet e integruara të ciklit të dytë për vitin akademik 2017-2018”**

Mbështetur në shkresën nr. 25 prot dt. 09.01.2017 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe shkresën nr.41 prot, dt. 20.01.2017 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit mbi kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe ciklit të dytë “Master Profesional” e “Master Shkencor” për vitin akademik 2017- 2018, Senati akademik i mbledhur me dt. 19.01.2017 .

**V E N D O S I:**

A. Miratimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe ciklit të dytë “Master Profesional” e “Master Shkencor” për vitin akademik 2017- 2018, për *Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes:*

a- **Për ciklin e parë të studimeve “Bachelor”.**

1. Do të pranohen në ciklin e parë të studimeve “**Bachelor**” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas VKM Nr. 407, dt. 01/06/2016.
2. Kandidatët janë të detyruar t’i nënshtrohen konkurimit praktik sipas testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.

3. Mbështetur në Vendimin Nr. 7 Prot., dt. 18/01/2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatare do të jetë në kufijtë 60 % me 40 %.
4. Kanë të drejtë të konkurojnë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjeksore të miratuar nga UST dhe të shpallur në faqen ëeb të UST.

**b- Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”.**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “**Master Profesional**” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë FSHL apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen ëeb të UST.
3. Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin “Bachelor” në sistemin Full – Time dhe Part – Time pranë FSHLsë.
5. Në rast se do të rezultojnë vende të mbetura bosh do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në IAL e tjera brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare sipas rendit zbritës.

**c- Për ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “**Master Shkencor**” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë FSHL apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare.

**B.** Miratimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe ciklit të dytë “Master Profesional” e “Master Shkencor” për vitin akademik 2017- 2018 për

*Fakultetin e Ventimtarisë Fizike dhe Rekreacionit:*

**Për ciklin e parë të studimeve “BACHELOR”**

1. Do të pranohen në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas VKM Nr.407, dt.01.06.2016.
2. Kandidatët janë të detyruar t'i nënshtrohen konkurimit praktik sipas testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallur në faqen web të UST.
3. Mbështetur në Vendimin Nr.7 Prot., dt.18.02.2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatare do të jetë në kufijtë 60% me 40%.
4. Kanë të drejtë të konkurojnë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore të miratuar nga UST dhe të shpallur në faqen web të UST.

**Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”**


1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “Master Profesional” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i përzgjedhjes do të jetë ai i notës mesatare.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin “Bachelor” në sistemin Full- Time dhe Part - Time pranë FVFR.
5. Në rast se do të rezultojnë vende të mbetura bosh do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare sipas rendit zbritës.

**Për ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “Master Shkencor” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i përzgjedhjes do të jetë ai i notës mesatare, ku fitues do të përzgjidhen studentët me notë mesatare të lartë.

4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin “Bachelor” në sistemin Full-Time dhe Part-Time pranë FVFR.
5. Në rast se do të rezultojnë vende të mbetura bosh do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në IAL e tjera brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e natës mesnate sipas rendit zbritës.

- Ky vendim përcillet në MAS.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Prof. Dr. Agron CUKA**  
  
**Kryetar i Senatit Akademik**

